



BULETIN MUJOR

KORRIK 2024



PËRMBAJTJA

- Cyber Fortress 2024
- Takimi Konsultues për Menaxhimin e Incidenteve të Sigurisë së Informacionit
- Konferenca e Nivelit të Lartë e Sigurisë Kibernetike
- Zhvillohet trajnimi dy-ditor për sektorin e Turizmit dhe atë të Prodhimit mbi Sigurinë Kibernetike
- Takimi i metodologjisë për "Përcaktimin e procedurave për identifikimin, klasifikimin, përshkallëzimin dhe menaxhimin e krizës kibernetike"
- Konsultimi final për Metodologjinë Kombëtare të Vlerësimit të Rrezikut të Sigurisë Kibernetike

Cyber Fortress 2024



AKSK, në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizoi eventin Cyber Fortress më 23-24 Korrik. Ky aktivitet dy-ditor bashkoi ekspertë të sigurisë kibernetike nga Shqipëria dhe Kosova në një simulim të incidenteve kibernetike, duke përdorur skenarë të ndryshëm dhe sfidues.

Pjesëmarrësit, të ndarë në ekipe, konkuruan për të zgjidhur skenarët e incidenteve kibernetike, duke u fokusuar në krijimin e zgjidhjeve, në vlerësimin dhe diskutimin e tyre për të arritur rezultatet më të mira.

Aktivitetet të tilla janë tejet të rëndësishme për përgatitjen dhe forcimin e kapaciteteve të ekspertëve të sigurisë kibernetike, duke qënë se mundësojnë kombinimin e zgjidhjeve teknike me buxhetin e alokuar.

Ekipet e mbrojtjes nëpërmjet trajnimeve të tilla shkëmbejnë e njohuritë dhe përvojat, duke kontribuar në një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucioneve dhe vendeve të rajonit në përballimin e sfidave kibernetike.

Takimi Konsultues për Menaxhimin e Incidenteve të Sigurisë së Informacionit

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi në datën 2 Korrik takim konsultues mbi Procedurën e Menaxhimit të Incidenteve të Sigurisë së Informacionit, një dokument ky thelbësor i hartuar nga Autoriteti për të mbrojtur Infrastrukturat Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit nga kërcënimet kibernetike.

Duke zbatuar këtë procedurë, AKSK synon të rrisë qëndrueshmërinë kombëtare kundër kërcënimeve kibernetike dhe të sigurojë mbrojtjen e vazhdueshme të infrastrukturave kritike të informacionit të Shqipërisë.

AKSK mbetet i angazhuar për të garantuar pjesëmarrje, transparencë, efikasitet dhe koherencë në proceset e vendimmarrjes për sigurinë kibernetike.

Ky takim u zhvillua me mbështetjen e Risi Albania, me pjesëmarrjen e mbi 60 ekspertëve të infrastrukturave të informacionit.



Address : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



Konferenca e Nivelit të Lartë e Sigurisë Kibernetike



U zhvillua në Tiranë Konferenca e Nivelit të Lartë e Sigurisë Kibernetike, organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) me mbështetjen e Bashkimit Europian. Me praninë e zëvendëskryeministres, znj. Belinda Balluku, Shqipëria prezantoi arritjet dhe sfidat në fushën e sigurisë kibernetike.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi nevojën për bashkëpunim midis vendeve të rajonit për të sjellë praktikat më të mira në luftën kundër sulmeve kibernetike, si dhe për përfshirjen e Ballkanit Perëndimor në programet e mbështetjes së Bashkimit Europian në këtë fushë.


Kjo konferencë bëri bashkë përfaqësues nga vendet e rajonit, organizatat ndërkombëtare, sektori privat dhe akademia. Aktivitete të tilla kontribuojnë në avancimin e bashkëpunimit rajonal dhe përforcojnë angazhimin tonë për sukses në këtë betejë.

Zhvillohet trajnimi dy-ditor për sektorin e Turizmit dhe atë të Prodhimit mbi Sigurinë Kibernetike

AKSK, i angazhuar maksimalisht në rritjen e kapaciteteve të stafit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si dhe institucioneve të pavarura, organizoi një trajnim dy-ditor për Sektorin e Turizmit dhe atë të Prodhimit.

Fokusi kryesor ishte njohja dhe ndërgjegjësimi i personelit të IT/ICT në fushën e sigurisë kibernetike, aftësimi për t'u përgjigjur ndaj incidenteve kibernetike, si dhe përgatitja e tyre në identifikimin e kërcënimeve nëpërmjet Cyber Drill (CD) – simulime reale të incidenteve të sigurisë kibernetike.

Ky takim u zhvillua me mbështetjen e projektit "Siguria Kibernetike e Qëndrueshme dhe e Përgjegjshme në Ballkanin Perëndimor", i implementuar nga Qendra e Gjenezës për Qeverisje të Sektorit të Sigurisë (DCAF) dhe financuar nga Mbretëria e Bashkuar.





Takimi i metodologjisë për “Përcaktimin e procedurave për identifikimin, klasifikimin, përshkallëzimin dhe menaxhimin e krizës kibernetike”



Një metodologji për “Përcaktimin e procedurave për identifikimin, klasifikimin, përshkallëzimin dhe menaxhimin e krizës kibernetike”, hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, u konsultua në takimin e zhvilluar për këtë qëllim.

Ky dokument synon të përcaktojë procedurat për identifikimin e një krize kibernetike, si dhe veprimet që duhen ndërmarrë nga të gjithë aktorët kombëtarë për të menaxhuar një situatë të tillë.

AKSK falënderon Risi Albania për mbështetjen dhe të gjithë ekspertët pjesëmarrës për kontributin e tyre në përmirësimin e këtij dokumenti.

Konsultimi final për Metodologjinë Kombëtare të Vlerësimit të Rrezikut të Sigurisë Kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike prezantoi në datë 10 Korrik draftin final të Metodologjisë Kombëtare të Vlerësimit të Rrezikut të Sigurisë Kibernetike.

Kjo Metodologji është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike” dhe synon të sigurojë një kornizë gjithëpërfshirëse për identifikimin, vlerësimin, zbutjen dhe menaxhimin e rreziqeve kibernetike në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit dhe është në përputhje me Kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian (NIS2).

